



KONTROLI POLITIK DHE MBIKËQYRJA E QEVERISË DHE BARTËSVE TJERË TË FUNKSIONEVE PUBLIKE NGA KUVENDI

Kontrolli politik dhe mbikëqyrja e Qeverisë dhe bartësve tjerë të funksioneve publike nga Kuvendi paraqet një rëndësi të madhe në kompetencat e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktuara me Kushtetutë. Mekanizma më të rëndësishme për realizim të këtij funksioni kontrollues dhe mbikëqyrës të Kuvendit janë: pyetjet e deputetëve, interpelanca, komisionet anketuese, mocioni i Qeverisë dhe debatet mbikëqyrëse.

PYETJET E DEPUTETËVE

Secili deputet ka të drejtë t'i parashtrojë pyetje Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (Kryeministrit), ndonjë anëtarit të qeverisë dhe bartësve tjerë të funksioneve publike, të cilët janë përgjegjës para Kuvendit. Pyetjet kanë të bëjnë me punën e tyre dhe çështjet rreth kompetencave të tyre. Pyetja mund të parashtrohet gojarisht ose me shkrim. Pyetje gojore mund të parashtrohen në seancë parlamentare, ndërsa pyetjet me shkrim parashtrohen përmes kryetarit të Kuvendit në periudhën ndërmjet dy mbledhjeve.

Çdo të enjten e fundit të muajit konvokohet seancë e posaçme në Kuvend për parashtrim të pyetjeve të deputetëve. Në mbledhje detyrimisht marrin pjesë edhe bartësit e funksioneve publike, për të cilët është paralajmëruar se do të parashtrohen pyetje. Nëse Kryetari i Qeverisë për arsye objektive ose të paprolongueshme e ka patjetër ta braktis mbledhjen, nuk ka të drejtë të mungojë nga mbledhja më shumë se një orë.

Në një mbledhje deputeti mund të parashtrojë më së shumti tre pyetje. Parashtrimi i pyetjeve të deputetëve nuk mund të zgjatë më shumë se dhjetë minuta. Deputeti po ashtu ka të drejtë të deklarohet, nëse është i kënaqur me përgjigjen, por jo më gjatë se tre minuta. Përgjigja e pyetjes

së parashtruar gojarisht nuk mund të zgjasë më tepër se dhjetë minuta.

Radhitjen e parashtrimit të pyetjeve të deputetëve e përcakton kryetari i Kuvendit në marrëveshje me koordinatorët e grupeve parlamentare, në proporcion dy me një në favor të deputetëve të grupeve parlamentare të opozitës dhe të deputetëve të opozitës, të cilët nuk janë të organizuar në grupe parlamentare.

Për ta verifikuar radhitjen e parashtrimit të pyetjeve, deputetët e informojnë kryetarin e Kuvendit për qëllimin e tyre për të parashtruar pyetje të deputetëve, edhe atë 24 orë para mbajtjes së mbledhjes. Deputetët nuk e kanë për detyrë të paralajmërojnë se kujt ia parashtrojnë pyetjen me gojë, përveç nëse pyetja ka të bëjë me bartës të ndonjë funksioni publik, që nuk është anëtar i Qeverisë. Nëse pyetja ka të bëjë me bartës të tillë të funksionit publik, atëherë deputeti është i detyruar të paralajmërojë se kujt ia parashtron pyetjen, që të mund bartësi i funksionit publik të ftohet në mbledhje për parashtrim të pyetjeve të deputetëve.

Për pyetjen e parashtruar me gojë jepet përgjigje në mbledhjen e Kuvendit, në të cilën është parashtruar ajo. Për pyetjet e parashtruara për Kryetarin e Qeverisë përgjigjen e jep vetë Kryetari i Qeverisë ose ndonjë përfaqësues i saj, ndërsa për pyetjen e parashtruar për ndonjë anëtar të Qeverisë, përgjigje jep anëtarin. Në rast se pyetja parashtrohet për ndonjë bartës të ndonjë funksioni publik, përgjigjen e jep bartësi i funksionit publik.

Me përjashtime të caktuara, përgjigja mund të jepet edhe me shkrim, nëse për shkaqe të arsyeshme përfaqësuesi i Qeverisë, anëtarin i saj, ose bartësi i funksionit publik nuk është në gjendje të jep përgjigje me gojë. Përgjigja me shkrim jepet në afat prej njëzet ditësh. Përgjigja me shkrim i dorëzohet kryetarit të Kuvendit, i cili menjëherë ia

përcjell parashtruesit të kërkesës dhe gjithë deputetëve tjerë. Në mbledhjen e parë të ardhshme të paraparë për parashtrim të pyetjeve të deputetëve, kryetari e informon Kuvendin për përgjigjen e dhënë.

Pas pranimi të përgjigjes, deputeti i cili e ka parashtruar pyetjen ka të drejtë të parashtojë pyetje tjera në kohëzgjatje prej tre minuta. Nëse përgjigja ka të bëjë me pyetje, të cilat paraqesin sekret, atëherë Qeveria, gjegjësisht bartësi i funksionit publik mund të propozojë, që përgjigja të jepet në mbledhjen e Kuvendit pa prezencë të publikut. Për këtë propozim vendos Kuvendi me shumicë të dy të tretave të numrit të përgjithshëm të deputetëve. Pas pyetjeve të deputetëve dhe dhënies së përgjigjeve nuk hapet diskutim, madje as përgjigja e pakënaqshme nuk bart ndonjë përgjegjësi, por vetë publiciteti dhe përshtypja e lënë në publik i bën pyetjet e deputetëve mekanizëm të rëndësishëm të kontrollit. Praktika e transmetimit të seancave të Kuvendit në televizion paraqet faktor kyç, i cili i jep domethënie plotësuese këtij instituti.

INTERPELANCA

Interpelanca për dallim nga pyetjet e deputetëve paraqet procedurë më të ndërlukuar dhe instrument të kontrollit politik mbi Qeverinë, ose mbi një bartës konkret të funksionit publik, rezultati i të cilit mund ta rrezikojë ekzistimin e Qeverisë ose të bëjë, që Qeveria ta humbë besimin. Ndonëse qëllimi i interpelancës nuk ka të bëjë me identifikimin e përgjegjësisë së drejtpërdrejtë individuale, por hapje të diskutimit për çështje të interesit më të gjerë të shtetit, prapëseprapë mund të iniciohet edhe çështja e përgjegjësisë, nëse pranohet interpelanca. Interpelancë mund të iniciojnë së paku pesë deputetë në lidhje me punën e ndonjë bartësi konkret të funksionit publik, për punën e Qeverisë dhe individualisht për çdo anëtar të saj, si dhe në lidhje me çështje të punës së organeve shtetërore.

Interpelanca me elaborim dorëzohet vetëm me shkrim, e nënshkruar nga të gjithë deputetët, të cilët e dorëzojnë atë. Ajo dorëzohet deri të kryetari i Kuvendit, i cili menjëherë e përcjellë atë te pala, të cilës i drejtohet. Subjekti, për të cilin është nxitur interpelanca, ka të drejtë të dorëzojë përgjigje me shkrim deri të kryetari i Kuvendit më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të interpelancës. Interpelanca futet në rend të ditës në seancën e parë të ardhshme të Kuvendit, pas kalimit të 15 ditëve nga dita e dorëzimit të përgjigjes së deputetëve. Nëse përgjigja nuk ka të bëjë me afatin e dhënë, atëherë interpelanca futet në rend të ditës në seancën e parë të ardhshme të Kuvendit. Deputetët mund ta tërheqin interpelancën vetëm para fillimit të debatit.

Të drejtën për ta elaboruar interpelancën e ka njëri nga deputetët, që e kanë dorëzuar atë, edhe atë në kohëzgjatje prej 20 minutash. Subjekti për të cilin është iniciuar interpelanca ka të drejtë ta elaborojë përgjigjen e tij me shkrim ose të jep përgjigje me gojë për interpelancën e parashtruar në kohëzgjatje prej 20 minutash.

Debati pas interpelancës zgjat një ditë pune, deri sa të përfundojë lista deputetëve, të paraqitur për të marrë fjalën, ashtu që paraqitja dhe radhitja e deputetëve për të marrë pjesë në debat është e njëjtë me procedurën për parashtrim të pyetjeve të deputetëve. Debati përmbyllet me votim, me të cilin shprehet (mos)kënaqësia e Kuvendit me përgjigjen e marrë nga bartësi i funksionit publik, gjegjësisht nga përgjigja e Qeverisë, edhe atë më së voni deri në ora 24:00. Nëse Kuvendi e pranon interpelancën, merr vendim në të cilin e paraqet qëndrimin e vetë për pretendimet e interpelancës. Pakënaqësia si e tillë nuk inicion pasoja juridike për Qeverinë, ose për bartësin e funksionit publik, por një gjë e tillë mund të paraqesë hyrje në iniciimin e procedurës për përgjegjësi politike, ose të rezultojë me dorëheqje të Qeverisë ose të bartësit të funksionit publik. Për shembull, nëse deputetët nuk janë të kënaqur nga elaborimi i ministrit, për punën e të cilit është iniciuar interpelancë dhe pakënaqësinë e tillë e shprehin gjatë votimit, atëherë interpelanca mund të shkaktojë pasoje morale. Kjo do të thotë se ministri mund jep dorëheqje, ose kryeministri mund t'i propozojë Kuvendit shkarkimin e ministrit konkret. Në fakt, sipas rregullores së Kuvendit ndërpritet debati nëse parashtrohet pyetje për besimin e Qeverisë, nëse Qeveria, gjegjësisht bartësi i funksionit publik jep dorëheqje, ose nëse kryetari i Qeverisë jep propozim për shkarkimin e anëtarit të Qeverisë, për punën e të cilit është dorëzuar interpelancë.

Në historinë e deritanishme të demokracisë parlamentare të Maqedonisë, si inicues të të gjitha interpelancave paraqitet opozita parlamentare.

KOMISIONET ANKETUESE

Komisioni anketues është mekanizëm, i cili mundëson ex-post kontroll mbi Qeverinë dhe mbi institucionet tjera, të cilat për punën e tyre janë përgjegjës para Kuvendit.

Komisioni anketues është organ, i cili mund të bazohet në vendimin e Kuvendit, me qëllim që të kryhet funksioni i kontrollit politik për të gjitha sferat dhe për çdo çështje të interesit publik.

Propozim për themelim të komisionit anketues mund të dorëzojnë së paku 20 deputetë. Përrjashtim nga ky rregull paraqet Komisioni për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të qytetarit, që është komision i përhershëm anketues. Fushëveprimi dhe përbërja e komisioneve anketuese verifikohet me vendimin për themelim

të tyre, ashtu që kryetarët e komisioneve anketuese sipas rendit të gjërave vijnë nga deputetët e grupeve parlamentare të opozitës. Komisionet anketuese themelohen me qëllim që të verifikohen faktet dhe rrethanat në lidhje me çështjet kontroverze, për të cilat janë kompetentë ministrat dhe organet tjera të pushtetit shtetëror. Komisioni anketues ka për detyrë të bëjë verifikimin e dokumentacionit, të analizojë ndonjë ndodhi ose rast të posaçëm dhe t'i prezantojë konstatimet para Kuvendit. Komisionet anketuese nuk mund të kenë funksione investiguese dhe gjyqësore, por konstatimet e tyre mund të jenë bazë për iniciimin e procedurës për verifikim të përgjegjësisë të bartësve të funksioneve publike.

MOCIONI NDAJ QEVERISË

Mocioni ndaj Qeverisë paraqet instrumentin më të fuqishëm të Kuvendit për kontroll të pushtetit ekzekutiv. Mocion ndaj qeverisë mund të iniciojnë së paku 20 deputetë me shkrim dhe me elaborim të shkaqeve. Kuvendi mund të votojë mosbesim me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (me shumicë absolute). Edhe pse procedura për iniciim të mocionit ndaj Qeverisë është relativisht e lehtë, praktika dëshmon se shumë rrallë mund të votohet mosbesimi i Qeverisë. Në praktikën e deritanishme të parlamentarizmit të Maqedonisë, vetëm njëherë është votuar mosbesim i një qeverie.

Mocionin mund ta iniciojë edhe kryetari i Qeverisë me shkrim ose me gojë në seancën e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit iniciimin e mocionit menjëherë e prezanton para deputetëve, Qeverisë dhe kryetarit të Republikës. Në rast se kërkesa parashtrohet gojarisht në seancën e Kuvendit, kryetari i Kuvendit e informon kryetarin e Republikës. Iniciimi i mocionit mund të tërhiqet deri para fillimit të mbledhjes së Kuvendit, në të cilën diskutohet për çështjen e besimit të Qeverisë. Për iniciimin e mocionit të Qeverisë, kryetari i Kuvendit menjëherë e konvokon mbledhjen, e cila mbahet në ditën e tretë pas iniciimit të mocionit. Afati fillon të llogaritet ditën e ardhshme pas ngritjes së mocionit.

Pas parashtimit të pyetjes për mocionin të Qeverisë zhvillohet debat në Kuvend. Të drejtën për ta elaboruar mocionin për votim të (mos) besimit të Qeverisë e ka njëri nga deputetët, të cilët e kanë parashtuar mocionin dhe për të ka 30 minuta në dispozicion. Radhitja e deputetëve, të cilët do të marrin pjesë në debat përcaktohet në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit dhe me koordinatoret e grupeve parlamentare para fillimit të seancës. Deputeti gjatë debatit mund të flet më shumë herë, por gjithsej 15 minuta, ndërsa koordinatori i grupit parlamentar mund të flet gjithsej 20 minuta.

Kuvendi i voton mocionin Qeverisë pas përfundimit të ditës së tretë, nga dita e parashtimit të pyetjes për mocion. Në rast se pyetjen për mocionin të Qeverisë e parashtrojnë gojarisht kryetari i Qeverisë në seancë të Kuvendit, Kuvendi voton për mocionin të Qeverisë në të njëjtën seancë. Kryetari i Qeverisë ka të drejtë t'i drejtohet Kuvendit para votimit të mocionit.

Nëse Qeverisë i votohet mocion për mosbesim, kryetari i Qeverisë ia dorëzon dorëheqjen Kuvendit në afat prej 24 orësh nga votimi i mosbesimit. Për votimin e mosbesimit të Qeverisë dhe për dorëheqjen e dorëzuar, Kryetari i Kuvendit menjëherë e informon kryetarin e Republikës. Qeveria, së cilës i është votuar mosbesim ngel në krye të detyrës deri në zgjedhjen e Qeverisë së re. Ndërkohë në afat prej 90 ditësh nga votimi i fundit të besimit nuk mund të parashtrohet pyetje për votim të sërishëm të besimit të Qeverisë. Para këtij afati kërkesë për votim të besimit të Qeverisë mund të parashtrojë vetëm shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

DEBATET MBIKËQYRËSE

Debatet mbikëqyrëse paraqesin mekanizëm më të ri të kontrollit, që për herë të parë është vendosur me Ligjin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, të miratuar në gusht të vitit 2009. Në këtë mënyrë duke filluar nga janari i vitit 2010, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë rregullisht zhvillohen debate mbikëqyrëse.



Debat mbikëqyrës në temën "Përdorimi i fondeve të instrumentit për ndihmë paraderuese – IPA në Republikën e Maqedonisë"

Debatet mbikëqyrëse zhvillohen me qëllim që të merren informacione dhe opinione profesionale, në lidhje me verifikimin dhe implementimin e politikave, ekzekutimin e ligjeve dhe aktiviteteve tjera të Qeverisë dhe organeve të administratës së shtetit.

Debatin mbikëqyrës e realizon organi amë i punës së Kuvendit, në fushëveprimin e të cilit bën pjesë çështja, e cila është subjekt i debatit mbikëqyrës. Organi amë i punës mund të ftojë në mbledhje përfaqësues të Qeverisë ose të organeve të administratës shtetërore dhe të kërkojë prej tyre

informacione dhe shpjegime, të cilat janë temë të debatit mbikëqyrës. Në debatin mbikëqyrës mund të ftohen edhe persona tjerë, të cilët mund të japin informacione për çështjet, të cilat janë temë e debatit.

Për zhvillim të debatit mbikëqyrës, kryetari i grupit të punës e informon kryetarin e Kuvendit, i cili pastaj e informon me shkrim Qeverinë dhe kërkon të emërojë përfaqësues të autorizuar për çështjet, të cilat janë temë e debatit mbikëqyrës. Pastaj kryetari i grupit të punës i fton me shkrim përfaqësuesit e autorizuar në seancën e grupit të punës, në të cilën do të zhvillohet debati mbikëqyrës. Ai mund të kërkojë nga përfaqësuesit e autorizuar, që informacionet, opinionet dhe qëndrimet e tyre t'i dorëzojnë në formë të shkruar më së voni tri ditë para se të zhvillohet seanca e grupit të punës.

Iniciativën për zhvillimin e debatit mbikëqyrës mund ta iniciojë një anëtar i grupit amë të punës. Për zhvillim të debatit mbikëqyrës, grupi i punës vendos me shumicë votash nga numri i anëtarëve prezentë, së paku me një të tretën e numrit të

përgjithshëm të anëtarëve. Në situatat, në të cilat 15 deputetë do të kërkojnë me shkrim të zhvillohet debati mbikëqyrës, kryetari i grupit të punës është i detyruar ta konvokojë seancën. Rekomandim për mbajtjen e debateve të caktuara mbikëqyrëse deri te anëtarët e organit të punës mund të jep kryetari i Kuvendit, nënkryetarët dhe koordinatorët e grupeve parlamentare.

Gjatë debatit, anëtarët e grupit amë të punës, por edhe deputetët, të cilët nuk janë anëtarë tij, mund të parashtrojnë pyetje për përfaqësuesit e autorizuar të Qeverisë, për organet e administratës së shtetit dhe personave tjerë të ftuar në debat, vetëm në lidhje me çështje të cilat janë temë e debatit.

Pas përfundimit të debatit mbikëqyrës organi i punës në Kuvend dorëzon raport, në të cilin shënohet esenca e elaborimeve, madje mund të propozojë edhe konkluzione, të cilat ia dorëzon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Në parim këta konkluzione publikohen në ueb faqen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

- Çdo deputet ka të drejtë t'u parashtrojë pyetje kryetarit të Qeverisë dhe bartësve tjerë të funksioneve publike, të cilët janë përgjegjës para Kuvendit. Pyetjet e tilla kanë të bëjnë me punën e tyre dhe çështjet në lidhje me kompetencën e tyre. Për të parashtruar pyetje të deputetëve konvokohet një mbledhje e posaçme e Kuvendit të enjten e fundit të muajit.
- Së paku pesë deputetë mund të parashtrojnë interpelancë për punën e ndonjë bartësi konkret të funksionit publik, gjegjësisht të Qeverisë dhe secilit anëtar të saj veç e veç, si dhe për punën e organeve shtetërore. Interpelanca si e tillë nuk shkakton pasoja juridike për punën e Qeverisë ose të bartësve të funksioneve publike, por mund të paraqesë hyrje në iniciimin e procedurës për përgjigjësi politike ose të rezultojë me dorëheqje.
- Kuvendi me vendim mund të themelojë komisione anketuese për të gjitha sferat e interesit publik. Propozim për themelim të komisionit anketues mund të dorëzojnë së paku 20 deputetë.
- Kuvendi mund të votojë mocion për Qeverinë. Çështjen për votim të besimit të Qeverisë mund ta parashtrojnë së paku 20 deputetë, ndërsa vendimi për votim të mosbesimit merret me shumicë absolute.
- Debatet mbikëqyrëse zhvillohen me qëllim që të fitohen informacione dhe opinione profesionale në lidhje me verifikimin dhe implementimin e politikave, realizimin e ligjeve dhe aktiviteteve tjera të Qeverisë dhe organeve të administratës së shtetit.